



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.428/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale për Kryetar Komunë në Republikën e Kosovës, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.428/2025, e datës 09.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale për Kryetar Komunë në Republikën e Kosovës, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.428/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 09.11. 2025, ditën e zgjedhjeve lokale, zyrtari i Lëvizjes Vetëvendosje, Egzon Azemi, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook në profilin e tij zyrtar. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se në atë postim, Egzon Azemi ka shpërndarë një fotografi të madhe të kandidatit të LVV për kryetar të Prishtinës, Hajrullah Çeku, e cila përmban sugjerim për mënyrën e votimit e sipas tyre ky veprim përbën aktivitet propagandistik gjatë ditës së zgjedhjeve dhe si i tillë është shkelje e nenit për heshtjen zgjedhore, të përcaktuar me Ligjin nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë, ka bashkangjitur foton e postimit.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) theksohet se lidhur me postimin e Egzon Azemit nuk qëndron asnjë aspekt ligjor apo faktik. Postimi në fjalë është një fotografi e bërë në orët e hershme të mëngjesit me mbishkrimin “ Mirëmëngjes Prishtinë” pa asnjë thirrje për votim, pa përmendje të ndonjë subjekti politik, kandidati apo procesi zgjedhor. Tutje, në përgjigje shtojnë që sipas parimeve të lirisë së shprehjes, një publikim i tillë

nuk hyn në kategorinë e fushatës zgjedhore dhe rrjedhimisht nuk përben shkelje të heshtjes. Për këtë arsye, ankesa e PDK-së duhet të refuzohet e pabazuar në ligj dhe në fakte.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), lidhur me shkeljen e pretenduar të Egzon Azemi nga radhët e subjektit politik Levizjës Vetëvendosje (LVV), Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesën e tyre ka bashkangjitur postimin e zyrtarit në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjti postimin e ka bërë duke thyer heshtjen zgjedhore gjatë ditës së votimit.

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi nuk është specifikuar ora e publikimit të fotos në rrjetin social Facebook të zyrtarit ndaj të cili është ushtruar ankesa, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të fotos, Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."

Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se ankesa duhet të refuzohet, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se zyrtari, Egzon Azemi , nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka bërë publikimin me datë 09 Nëntor 2025 në ora 06:50 minuta, pra 10 minuta para fillimit të heshtjes zgjedhore, e jo ashtu siç ka pretenduar ankuesi me ankesë, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, në ndërkohë që me provat tjera është vërtetuar se ky postim ka ndodhur para hapjes së Qendrave të Votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.428/2025, datë 12.11.2025



Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.